



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 16
Prishtinë, më 15 korrik 2013, në orën 09:00, sala S-II
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Imri Ahmeti, Adem Grabovci, Afrim Hoti, Bali Muharremaj dhe Albert Kinolli.

Të ftuar: z.Bajram Rexhepi, ministër, z.Shpend Maxhuni, drejtor i përgjithshëm dhe Lars Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatore e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Saranda Kelmendi, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012;**
3. **Shqyrtimi i Raportit të auditimit-menaxhimi i prokurimit në Policinë e Kosovës për vitin 2012;**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012

Kryetari – Opinioni i auditimit për vitin 2012, për MPB-në, është opinionin i pakualifikuar me theksim të çështjes. Theksimi i çështjes është dhënë për shkak të shkeljeve të konstatuara në programin “Policia e Kosovës”, veçanërisht në fushën e prokurimit, si dhe në menaxhimin e flotës së policisë. Në vitin e kaluar, ZAP-i ka dhënë 10 rekomandime për MPB-në, ndërsa lidhur me këtë, kjo e fundit ka përgatitur një plan veprimi për adresimin e rekomandimeve të dala nga Raporti i auditimit. Nga rekomandimet e dhëna, vetëm 2 janë adresuar plotësisht, ndërsa 8 janë në proces të implementimit. Në kategorinë e shpenzimeve kapitale nga ndarja e buxhetit prej 15.6 milionë euro, janë shpenzuar 13.4 milionë euro apo 86% e ndarjes buxhetore për këtë kategori ekonomike. Mirëpo, mbi 60% e shpenzimeve në këtë kategori janë bërë në fund të vitit. Cilat ishin arsyet e pagesave të larta, të bëra në tremujorin e fundit të vitit?

Parregullsi janë vërejtur edhe në menaxhimin e stafit. 43 pozita janë të mbuluara me ushtrues detyre. Kjo tregon mungesën e krijimit të një sistemi të qëndrueshëm të kontrollit të brendshëm, në të cilin funksionon llogaridhënia. Cilat ishin arsyet e mosplotësisht të pozitive të punës me kontrata të rregullta pune? Subvencionet nuk ishin dhënë gjithëherë në përputhje me qëllimet e përcaktuara. Një pjesë e tyre ishin dhënë për stimulimin e stafit. Dhënia e tyre nuk kishte bazë ligjore. Nga e gjithë kjo, vijnë në përfundim se edhe procesi i certifikimit nuk kishte arritur të parandalojë shpenzimet e parregullta. Pse stafi është paguar nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, kur dihet se një gjë e tillë nuk është e lejuar? Me vendim të sekretarit MPB-së, të datës 3 shkurt 2012, lejohen mjete për pagesën shtesë të zyrtarëve në Departamentin e Financave, Departamentin e Prokurimit, Departamentin e Personelit dhe Departamentin për Fitimin e Shtetësisë, Azil dhe Migracion, pa ndonjë bazë ligjore. A është duke u vazhduar ende me këto pagesa dhe se cila ishte baza ligjore që sekretari i MPB-së të lejojë pagesa të tilla? Në PVF, shuma e obligimeve të raportuara ishte 2,473,281€. Këto obligime i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve 1,801,473€, investimeve kapitale 454,779€, shpenzimeve komunale 163,860 €, si dhe kategoria e subvencioneve dhe transfereve 53,169€. A është arritur të bëhet pagesa e këtyre obligimeve të mbetura, si dhe sa ka ndikuar kjo në buxhetin e vitit 2013? Unë iu referova pjesës së të gjeturave nga ZAP-i vetëm për MPB-në, ndërsa pjesën për Policinë do ta diskutojmë më pastaj.

Ramiz Lladrovci – Sipas të dhënave në këtë raport, vërehet se ka pasur përmirësime të dukshme. Një çështje që kërkon sqarim, mendoj se është shuma e borxheve të papaguara që nga viti i kaluar, në të cilin ka pasur rritje. Kjo ndikon direkt edhe në buxhetin e vitit 2013. Pozitat si ushtrues detyre, me kohëzgjatje mbi tre muaj, janë disa të gjetura të ZAP-it për vitin 2012, të cilat mendoj se duhet adresuar me kohë.

Valbona Dibra- Opinioni i dhënë nga ZAP-i për MPB-në, është i qëlluar dhe është pasqyrë reale, se këtu ka pasur përmirësime të dukshme nga viti paraprak. Theksimi i çështjes është tek regjistrimi i pasurisë dhe këtë vit edhe kjo çështje është adresuar. Shpenzimi i buxhetit mbi 94% është një tregues i mirë për angazhimin e tërë stafit të MPB-së në arritjen e objektivave. Sipas raportit të auditimit të MPB-së, është konstatuar se ekziston NJAB dhe KAB dhe se janë duke funksionuar mirë.

Imri Ahmeti - Edhe unë pajtohem se në MPB ka një progres, mirëpo njëra nga të gjeturat është në fushën e prokurimit dhe këtu ka përparime. Megjithatë, edhe në raportin e këtij viti ka të gjetura të cilat janë të lidhura direkt me fushën e prokurimit, si përgatitja dhe dorëzimi me vonësë i planit preliminar të prokurimit, përgatitja e specifikacionit teknik, duke u referuar në një prodhim specifik, ndarje e tenderëve dhe mosaplikimi i procedurës së hapur, mosrespektimi i afateve kohore për kryerjen e shërbimeve etj.

Bajram Rexhepi - ministër në MPB – Në vitin 2012, kishte përmirësime të dukshme dhe kjo më së miri vërehet në raportin e ZAP-it. Megjithatë, ekzistojnë ende sfida të cilat po mundohemi që bashkërisht me stafin t'i adresojmë. Nga 10 rekomandime të vitit të kaluar, dy janë adresuar, ndërsa 8 të tjera janë në proces. Është e vërtetë se kemi ngecje në ekzekutimin e buxhetit kapital, ndërsa kjo për shkak të dështimit në përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë. Po ashtu, problem në vete është edhe numri prej 43 zyrtarëve të cilët janë në pozita pune si ushtrues detyre. Ndoshta, defekti për këtë është për shkak të kriterëve strikte të përcaktuara nga MPB-ja. Procedurat e stërzgjidura edhe të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, po paraqesin pengesë për rekrutim të stafit. Pagesa e subvencioneve- MPB-ja ka përgjegjësi të tjera edhe me liberalizim të vizave dhe integritet evropiane. Kjo ishte arsye e pagesave të stafit nga subvencionet dhe tanimë kjo është ndërprerë. Borxhet e papaguara, është e vërtetë se kemi një shumë të mjetëve si borxhe të papaguara, mirëpo kjo është jo për fajin e MPB-së. Shpenzimet në kapitale janë të ulëta, për shkak të proceduarve në prokurim. Për mua me rëndësi është që nuk ka pasur shpenzime të panevojshme, se sa të ketë ngecje në realizim të buxhetit. Ne kemi krijuar një njësi për menaxhimin e kontratave dhe mendoj se kjo do të japë rezultate. Regjistrimi i pasurisë- ka pasur progres, një problem ka qenë tek furnizimi me autobllinda, ku koha e furnizimit ishte fundi i dhjetorit dhe fillimi i janarit dhe kjo është rregulluar në fillim të vitit 2013. Problemet me Flotën- mendoj se duhet të gjendet një mënyrë e partneritetit publiko-privat. Situatë e ngjashme është edhe me pastrimin e veturave.

Driton Gashi, sekretar në MPB – Tha se ka marrë përsipër që të gjitha të gjeturat t'i adresojë për një kohë sa më të shkurtër të mundshme. Aktualisht, jemi duke identifikuar shkaqet që e kanë sjellë MPB-në deri tek këto gjetje. Njëra nga këto, është Zyra e Auditorit të Brendshëm, dhe për këtë kemi bërë dy pozita plus, që t'i ndihmojnë auditorit. Të gjitha masat që jemi duke i ndërmarrë, janë në kontest të përmirësimit të fushave të vlerësuara si jo mirë nga ZAP-i. Deri në fund të vitit 2013, të gjeturat do të adresohen.

Artan Venhari – ZAP-i ka vërejtur se ka përmirësime dhe hapat që ka vendosur të ndërmarrë menaxhmenti i MPB-së, janë shprehëdhënëse se të gjeturat do të adresohen saktë dhe drejt.

Mursel Haljilji – Mua më intereson që ky plan gjithëpërfshirës, të realizohet në kohë sa më të shkurtër dhe të respektohen afatet kohore. ZAP-i ka dhënë opinionin për këtë Ministri, si opinion të pakualifikuar në theksim të çështjes.

Ramiz Lladrovci- KMFP-së i duhet një plan veprimi se deri kur do të adresohen rekomandimet dhe në cilat fusha. MPB-ja ka filluar në adresimin e rekomandimeve, por për Komisionin është me rëndësi të ketë planin e veprimit me afate kohore të përcaktuara saktë për adresim.

Imri Ahmeti – Pyeti: A keni filluar me rishikim të kontratave në kontest të përmirësimit të gabimeve të ndodhura si në kontratën për furnizim me naftë?

Kryetari- Propozoi që pani i veprimit t'i dorëzohet KMFP-së dhe ZAP-it, deri në fund të shtatorit 2013.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

Ministria e Punëve të Brendshme, deri në fund të muajit shtator, të dorëzojë në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të dala

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit-menaxhimi i prokurimit në Policinë e Kosovës për vitin 2012

Kryetari - Njësia e Flotës Operative ende nuk ka arritur të krijojë një bazë të të dhënave për automjetet të cilat presin për servisim. Kjo njësi nuk ka një pasqyrë reale për numrin e saktë të automjeteve që presin për servisim, gjendjen e tyre në të cilën janë pranuar, kohën e pranimi, si dhe afatin kohor për servisimin e tyre. Me rastin e ekzaminimit fizik nga ana e auditorëve, është vërejtur se kishte automjete që prisnin për riparim dhe nuk figuronin fare në regjistrin e automjeteve që janë në pritje për servisim. Si qëndron situata këtë vit, a është bërë progres në këtë drejtim? Policia e Kosovës edhe gjatë vitit 2012, nuk ka arritur të përmirësojë nivelin e kontrollit të Flota e Policisë. Pjesa më e madhe rekomandimeve të dala nga raporti i auditimit, nuk janë adresuar. Edhe më tutje një pjesë e madhe e investimeve të bëra, si në garazhin për servisim të veturave dhe autolarje, janë edhe më tutje jashtë përdorimit. Cila është përgjegjësia e juaj në këtë? Po ashtu, çështja e servisimit të veturave, që në disa raste ka kushtuar më shumë sesa çmimi blerës.

Ramiz Lladrovci – Të gjeturat e ZAP-it në Policinë e Kosovës janë në fushën e prokurimit, megjithatë kërkojmë nga menaxhmenti i Policisë së Kosovës, të merren masa në këtë drejtim.

Afrim Hoti - Pyeti për kontratën për furnizim me dy autoblanda në shumën prej 790,418, e cila ende nuk është realizuar, ku janë shkaqet për këto vonesa?

Mursel Haljilji- Pyeti për automjetet të cilat ishin jashtë funksionit. A ka ndikuar kjo në funksion të kryerjes së detyrave të Policisë së Kosovës?

Fahredin Verbovci, Policia e Kosovës – Tha se të gjitha rekomandimet e dhëna nga ZAP-i për PK-në janë si plan i punës për adresimin e tyre. PK-ja ka një flotë mbi 1 mijë vetura dhe është vështirë të menaxhohen. Po ashtu, është e vërtetë se në disa raste edhe servisimi i tyre ka kushtuar më shtrenjtë sesa çmimi blerës. Mirëpo, ne jemi të përkushtuar që këto dobësi, me ndihmën Departamentit Amerikan të Shtetit, t'i zgjidhim këto çështje. Do të mundohemi që të lirohemi nga veturat, të cilat nuk janë në funksion, në mënyrë që shpenzimet për servise të jenë më të vogla.

Bajram Rexhepi – Çështja e dy autoblandave, është kontraktuar shuma dhe mjetet nuk janë dhënë. Policia e Kosovës ka nevojë për ato autoblanda, por ata që e kanë bërë kontraktimin, janë nën hetime dhe kemi qenë në dilemë që ta shohim a mund të vazhdojmë me të njëjtën kompani. Pra, edhe në këtë rast kemi një pengesë ligjore. Në vitin 2012, mjetet që kanë qenë të zotuar nga Ministria e Financave, i kanë marrë për rritje të rrogave nga resurset e brendshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme, pra afër katër ose pesë milionë iu kanë marrë dhe kemi lejuar lëvizjet, prej një pozicioni në pozicion tjetër dhe do të realizohet. Edhe çështja “*furnizimi me municion dhe gazra*” këtu bëhen kontrata specifike, mirëpo furnizuesi dhe prodhuesi duhet të japin leje deri te përdoruesi i fundit. Sa i përket kontraktuesit, ai nuk ka pasur pengesë, mirëpo vonesat kanë ardhur nga vetë prodhuesit.

Është brengë e madhe që ne figurojmë me një flotë të madhe, ku një numër i madh i tyre nuk funksionon në Qeveri. Janë gati 70, ndërsa në polici mund të ketë edhe më shumë. Ne duhet të lirohemi nga ato automjete, të cilat nuk janë në funksion ku përmes Ministrisë së Tregtisë të bëjmë një opsion dhe të lirohemi nga ato dhe të marrim vetura të reja.

Kryetari – Propozoi që Pani i veprimit t'i dorëzohet KMFP-së, si dhe ZAP-it deri në fund të shtatorit 2013.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

Policia e Kosovës, deri në fund të muajit shtator, të dorëzojë në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të dala nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30.
E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu